



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.425/2021
Datë: 29 dhjetor 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1, 1.12, nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 34 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, në takimin 274-të, të mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

- I. Z. Driton Muharremi, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë, propozohet tek Presidentja e Republikës së Kosovës, për lirim nga detyra e gjyqtarit, për shkak të përfundimit të mandatit, me dorëheqje.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 29 dhjetor 2021.

A r s y e t i m

Konform nenit 34 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, gjyqtarit Driton Muharremi, sipas fuqisë ligjore i përfundon mandati i gjyqtarit, pasi që i njëjti më datë 24 dhjetor 2021, ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit.

KGJK, bazuar në nenin 26 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i propozon Presidentes së Republikës së Kosovës Sh.S.Znj. Vjosa Osmani – Sadriu, të liroj nga detyra gjyqtarin Muharremi.

Andaj, nga se u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe
- Arkivit.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës